LIGJ
Nr.8376, datë 16.7.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7815, DATË 20.4.1994 "PËR BARNAT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7815, datë 20.4.1994 " Për barnat" neni 8 ndryshohet si vijon:

"Barnat mund të fabrikohen në vend vetëm pas marrjes së autorizimit përkatës nga Ministri i Shëndetësisë, sipas rekomandimit të Komisionit të Verifikimit të Kushteve të Fabrikimit të Barnave.

Komisioni i Verifikimit të Kushteve të Fabrikimit të Barnave ngrihet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe funksionon sipas rregullores së miratuar prej tij."

Neni 2

Në nenin 9, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB) regjistron autorizimet e lëshuara, si dhe barnat që do të fabrikohen. Mosmiratimi i kërkesës për fabrikimin e barnave duhet të jetë i motivuar."

Neni 3

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"Leja e regjistrimit të barnave jepet nga Ministri i Shëndetësisë, sipas rekomandimit të dhënë nga Komisioni i Nomenklaturës së Barnave dhe Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave. Komisioni i Nomenklaturës së Barnave është organ Këshillimor i Ministrit të Shëndetësisë dhe funksionon sipas rregullores së miratuar prej tij."

Neni 4

Neni 14 ndryshohet si vijon:

"Regjistrimi i barnave bëhet në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave, sipas rregullores së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

Barnat regjistrohen vetëm kur plotësojnë kriteret e efektshmërisë dhe të sigurisë, në përputhje me qëllimin e përdorimit."

Neni 5

Neni 46 ndryshohet si vijon:

"Reklama e barnave në publik me anën e mjeteve të informimit masiv lejohet me miratimin e Ministrit të Shëndetësisë. Rregullat për reklamën dhe lista e barnave që lejohen të propagandohen në publik nepërmjet reklamës përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë."

Neni 6

Neni 52 ndryshohet si vijon:

"Autoritetet e kontrollit të përcaktuara në nenin 49 të këtij ligji, në rastet kur fabrikimi, kontrolli dhe ruajtja e barnave bëhet në kundërshtim me kërkesat e praktikës së fabrikimit të mirë dhe

të praktikës së ruajtjes së mirë, si dhe kur tregtimi me shumicë e pakicë, importimi dhe eksportimi i barnave bëhet në kundërshtim me rregullat dhe standardet përkatëse, të miratuara sipas këtij ligji, urdhërojnë pezullimin e këtyre veprimtarive, si dhe bllokimin ose konfiskimin e barnave.

Barnat e bllokuara apo të konfiskuara, që janë jashtë standardeve të vendosura, asgjësohen sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacionin e mbrojtjes së mjedisit me shpenzimet e subjektit që ka bërë shkeljen, ndërsa kur ato janë të përdorshme kalojnë në administrim të Ministrit të Shëndetësisë

Vendimi për vazhdimin e metejshem apo për ndalimin e veprimtarive dhe të subjekteve të këtij ligji, merret nga autoritetet që kanë të drejtën t'i autorizojnë ose t'i licencojnë ato".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 1 shtator 1998.

Shpallur me dekretin nr.2171, datë 28.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani